
	Procedura e Rregullave të Tregut për Caktimin e Energjisë së Matur	PR-MO-008
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 1 deri 8</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

**Operatori i Sistemit të
Transmisionit dhe Tregut
të Kosovës
(KOSTT)**

**Procedura e Rregullave të Tregut për
Caktimin e Energjisë së Matur**

Shkurt 2015

	Procedura e Rregullave të Tregut për Caktimin e Energjisë së Matur	PR-MO-008
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 2 deri 8</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Kjo procedurë e **Rregullave të Tregut** (duke përfshirë edhe amendamentet e mëvonshme) është përpiluar në përputhje me paragrafin 16.4.2 të **Rregullave të Tregut** që janë përgatitur në përputhje me Nenin 24 (paragrafi 6) të Ligjit Nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike.

Procedura e Rregullave të Tregut për Caktimin e Energjisë së Matur

PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1 Objektivat dhe Fushëveprimi


1.1 Objektivat

1.1.1 Kjo procedurë përcakton mënyrën se si **Energjia e Matur** në **Rrjetin e Shpërndarjes** që nuk është liferuar në një **Sistem Matës Interval** është alokuar ndërmjet **Furnizuesve të Sistemeve Matëse Jo-Interval** në një **Periodë të Barazimit Përfundimtar**.

1.2 Fushëveprimi

1.2.1 Në përputhje me (dhe si përcaktohet) paragrafin 16.4.2 të **Rregullave të Tregut, OT** do të kalkuloj **Energjinë e Matur të Njesisë Furnizuese** për **Sistemet Matëse Jo-Interval** në çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** si në vijim:

- (a) Energjia që duhet t'i alokohet **Sistemit Matës Jo-Interval** është **Energjia e Matur** në **Rrjetin e Shpërndarjes** për atë **Periodë të Barazimit Përfundimtar** minus **Energjia e Matur e Njësive Furnizuese të Sistemeve Matëse Interval** minus **Humbjet në Shpërndarje**;
- (b) **Sasia Vjetore e Energjisë** që parashikohet se do të merr **Sistemi Matës Jo-Interval** i **Furnizuesit "A"** nga **Sistemi i Shpërndarjes**, (të ndryshëm nga **Sistemet Matëse të Furnizuesit Publik**) që nuk është marrë nga **Sistemi Matës Interval** dhe e llogaritur si **Përpjesa e Sistemit Matës të Furnizuesit** ($PSMF_{Ab}$) për **Sistemin Matës "b"**;
- (c) **Përpjesa e Sistemit Matës të Furnizuesit** aplikohet për të bërë alokimin e **Energjisë së Matur të Njesisë Furnizuese** tek **Sistemet Matëse Jo-Interval** të **Furnizuesit** relevant për qëllime të kalkulimit të **Jobalancit të Energjisë**.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Caktimin e Energjisë së Matur	PR-MO-008
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 3 deri 8</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

1.3 Termat e përdorura në këtë Procedurë të Rregullave të Tregut

1.3.1 Termat vijues do të përdoren në këtë Procedurë të Rregullave të Tregut:

- (a) **D1** është data fillestare në analizat vjetore të **Energjisë së Matur të Njesisë Furnizuese** tek **Sistemi Matës Jo-Interval** për nevoja të kalkulimit të **Sasisë Vjetore të Energjisë**;
- (b) **D365** është data e fundit në analizat vjetore të **Energjisë së Matur të Njesisë Furnizuese** tek **Sistemi Matës Jo-Interval** për nevoja të kalkulimit të **Sasisë Vjetore të Energjisë**;
- (c) **Energjia Dalëse Ditore Jo-Interval** ($EDDJI_d$) është shuma totale e **Energjisë së Matur të Njesisë Furnizuese** e **Sistemit Matës Jo-Interval** në ditën specifike;
- (d) **Indeksi i Energjisë Dalëse Vjetore** ($XIEDV_d$) është përpjesa e energjisë dalëse vjetore në **Sistemet Matëse Jo-Interval** që i atribuohet cilësdo ditë “d”;
- (e) **Dp_b** është dita e leximit të parë të **Njehsorit** në një **Sistem Matës Jo-Interval** “b” në **D1** ose pas saj;
- (f) **Df_b** është dita e leximit të fundit të **Njehsorit** në një **Sistem Matës Jo-Interval** “b” në **D365** ose pas saj;
- (g) **Sasia Totale e Energjisë Jo-Interval** është shuma e **Sasive Vjetore të Energjisë** e regjistruar në çdo vit


1.3.2 Të gjitha termet tjera në **bold** do të kenë të njëjtin kuptim sikurse termat e përdorura në legjislacionin në fuqi ose licenca, sipas rastit.

1.4 Principet e përgjithshme

1.4.1 **OT** do të aplikoj principin që profili për orë i daljeve në **Sistemet Matëse Jo-Interval** do të jetë i njëjtë për të gjitha **Sistemet Matëse** të tilla ashtu që **OT** do të jetë në gjendje të kalkuloj një profil unik për të gjitha **Sistemet Matëse Jo-Interval**, të cilat pastaj do t'i jepen **AAM** për nevoja të kalkulimit të **Sasisë Vjetore të Energjisë** për çdo **Sistem Matës Jo-Interval**.

1.4.2 **OT** do të kalkuloj profilin e daljes vjetore dhe **AAM** do të bëjë kalkulimin në baza vjetore të **Sasisë Vjetore të Energjisë**.

1.4.3 Brenda vitit, **Sasia Vjetore e Energjisë** nuk do të ndryshoj përveç në rastet kur një **Sistem Matës Jo-Interval** bëhet **Sistem Matës Interval**.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Caktimin e Energjisë së Matur	PR-MO-008
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 4 deri 8</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

1.4.4 **Përpjesa e Sistemit Matës të Furnizuesit** do të regjistrohet në bazën e të dhënave të **AAM** dhe do të azhurnohet në baza vjetore dhe do të ri-kalkulohet gjatë vitit kur:

- (a) **Sasia Vjetore e Energjisë** llogaritet për një **Sistem Matës Jo-Interval** të ri; ose
- (b) një **Sistem Matës Jo-Interval** bëhet **Sistem Matës Interval** ose shkyçet nga rrjeti;

por këto azhurnime do të bëhen vetëm në qoftë se **AAM** me arsye konsideron që ndryshimet e bëra në **Përpjesën e Sistemit Matës të Furnizuesit** janë të nevojshme.

1.4.5 Përveç nëse në këtë **Procedurë të Rregullave të Tregut** theksohet ndryshe në mënyrë eksplicite, **Sistemi Matës** i agreguar i **Furnizuesit Publik** (që përmban **Sisteme Matëse** që nuk janë të regjistruara ndaras tek **AAM** si dhe çdo **Sistem Matës Jo-Interval** i **Furnizuesit Publik** që tashmë është i regjistruar ndaras tek **AAM**) do të trajtohet sikurse edhe të gjitha **Sistemet Matës Jo-Intervale** përveç që, ku bëhet korrigjimi në rrethanat e përshkruara në paragrafin 1.4.4 ose paragrafin 3.2.2, korrigjimi rritës do të bëhet në **Sasinë Vjetore të Energjisë të Sistemit Matës** të agreguar të **Furnizuesit Publik** për të reflektuar **Sasinë Vjetore të Energjisë** të parashikuar të **Sistemeve Matëse** individuale që janë shtuar ose zbritur nga **Sistemi Matës** i agreguar i **Furnizuesit Publik**.

PJESA II: KALKULIMET

2 Kalkulimi i Sasive Vjetore të Energjisë

2.1 Indeksi i Profilit të Sasisë Vjetore të Energjisë dhe Sasia Ditore e Energjisë


2.1.1 Çdo vit (deri më 20 Dhjetor), **OT** do të merr të dhënat për **Energjinë e Matur të Njesisë Furnizuese** nga **Sistemet Matëse Jo-Interval** për 12 muajt e fundit dhe do të caktoj datën e parë (**D1**) për analizat e **Sasisë Vjetore të Energjisë** dhe datën e fundit (**D365**), e cila do të jetë 364 ditë pas datës **D1**.

2.1.2 Për çdo ditë ndërmjet **D1** dhe **D365**, **OT** do të kalkuloj **Energjinë Dalëse Ditore Jo-Interval** ($EDDJl_d$) për ditën “*d*” përmes formulës:

$$EDDJl_d = \sum_{j=1}^{24} \sum_b \left(-ENjF_{bdj} \right)$$

ku:

j është **Perioda e Barazimit Përfundimtar** në ditën “*d*”;

	Procedura e Rregullave të Tregut për Caktimin e Energjisë së Matur	PR-MO-008
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 5 deri 8</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

b është **Sistemi Matës Jo-Interval** (nëse është e aplikueshme përfshinë, **Sistemin Matës** të agreguar të **Furnizuesit Publik** që përmban **Sistemet Matëse** që nuk janë të regjistruara ndaras tek **AAM** si dhe çdo **Sistem Matës Jo-Interval** të **Furnizuesit Publik** që tashmë është i regjistruar ndaras tek **AAM**);

$ENjF_{bdj}$ **Energjia e Matur e Njësisë Furnizuese** e regjistruar në **Sistemin Matës Jo-Interval “b”** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar “j”** (që, për evitimin e dyshimeve është vlera negative sipas **Rregullave të Tregut** sepse bënë regjistrimin e energjisë që del nga sistemi).

2.1.3 Për çdo ditë ndërmjet **D1** dhe **D365**, **OT** do të kalkuloj **Indeksin e Energjisë Dalëse Vjetore** ($XIEDV_d$) për ditën “*d*” përmes formulës:

$$XIEDV_d = \frac{EDDJI_d}{\sum_{n=1}^{365} EDDJI_n}$$


ku:

$EDDJI_d$ është **Energjia Dalëse Ditore Jo-Interval** për ditën “*d*” e kalkuluar në përputhje me paragrafin 2.1.2.

2.2 Sasia Vjetore e Energjisë të Sistemit Matës – Sistemi Matës ekzistues

2.2.1 Për **Sistemin Matës Jo-Interval “b”** (të ndryshëm nga **Sistemi Matës** i agreguar i **Furnizuesit Publik** që përmban **Sisteme Matëse** që nuk janë të regjistruara ndaras tek **AAM** si dhe çdo **Sistem Matës Jo-Interval** të **Furnizuesit Publik** që tashmë është i regjistruar ndaras tek **AAM**), **AAM** do të:

- (a) Identifikoj:
 - (i) Ditën (**Dp_b**) në të cilën është marrë leximi i parë i **Njehsorit** në ditën **D1** ose pas kësaj dite; dhe
 - (ii) Ditën (**Df_b**) në të cilën është marrë leximi i fundit i **Njehsorit** në ditën **D365** ose pas kësaj dite; dhe
- (b) Kalkuloj sasinë e energjisë (E_b) të regjistruar si liferim përmes këtij **Sistemi Matës** ndërmjet **Dp_b** dhe **Df_b**; dhe
- (c) Kalkuloj **Sasinë Vjetore të Energjisë** (SVE_b) për **Sistemin Matës** përmes formulës:

	Procedura e Rregullave të Tregut për Caktimin e Energjisë së Matur	PR-MO-008
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 6 deri 8</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

$$SVE_b = \frac{E_b}{\sum_{n=dpb}^{n=dfb} XIEDV_n}$$

ku:

$XIEDV_n$ është **Indeksi i Daljes Vjetore të Energjisë** për ditën “n” i kalkuluar në përputhje me paragrafin 2.1.3.

- 2.2.2 **Sasia Vjetore e Energjisë (SVE_{FP})** e kalkuluar për **Sistemet Matëse** të agreguara të **Furnizuesit Publik** që përmban **Sistemet Matëse** që nuk janë të regjistruara ndaras tek **AAM** gjatë azhurnimit vjetor do të kalkulohet përmes formulës vijuese:

$$SVE_{FP} = \sum_{n=D1}^{D365} EDDJI_n - \sum_b SVE_b$$

ku:

$EDDJI_n$ është **Energjia Daljes Ditore Jo-Interval** për ditën “n” e kalkuluar në përputhje me paragrafin 2.1.2;

SVE_b është **Sasia Vjetore e Energjisë e Sistemit Matës Jo-Interval “b”** (i cili nuk është **Sistem Matës** i agreguar tek **Furnizuesi Publik** që përmban **Sistemet Matëse** që nuk janë të regjistruar ndaras tek **AAM** si dhe çdo **Sistem Matës Jo-Interval** të **Furnizuesit Publik** që tashmë është i regjistruar ndaras tek **AAM**).


2.3 Sasia Vjetore e Energjisë të Sistemit Matës – Sistemi Matës i ri

- 2.3.1 **Sistemi Matës** i ri konsiderohet **Sistemi Matës** i futur në **Bazën e Matjeve** të **AAM** pas datës **D1**.
- 2.3.2 Për një **Sistem Matës Jo-Interval**, **Furnizuesi** do të dorëzoj një përafrim të arsyeshëm të **Sasisë Vjetore të Energjisë** tek **AAM** për **Sistemin Matës** të regjistruar në **Bazën e Matjeve** të **AAM**.

3 Përpjesa e Sistemit Matës të Furnizuesit

3.1 Sasia Totale e Energjisë Jo-Interval

- 3.1.1 Çdo vit (deri me 20 Dhjetor), pas kalkulimit të **Sasisë Vjetore të Energjisë** për çdo **Sistem Matës Jo-Interval**, **AAM** do të kalkuloj **Sasinë Totale të Energjisë**

	Procedura e Rregullave të Tregut për Caktimin e Energjisë së Matur	PR-MO-008
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 7 deri 8</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Jo-Interval si shumë e **Sasive Vjetore të Energjisë** të të gjithë **Sistemeve Matëse Jo-Interval** dhe do ta regjistroj këtë sasi totale.

3.1.2 Në çdo kohë pasi që të jetë kalkuluar **Sasia Totale e Energjisë Jo-Interval**, kjo do të korrigjohet sa herë që një **Sasi Vjetore e Energjisë** në lidhje me **Sistemin Matës Jo-Interval** është shtuar në rrethanat e përshkruara në paragrafin 1.4.4(a) ose kur një **Sasi Vjetore e Energjisë** e një **Sistemi Matës Jo-Interval** të hequr në rrethanat e përshkruara në paragrafin 1.4.4(b).

3.2 Ri-kalkulimi i Përpjesës së Sistemit Matës të Furnizuesit

3.2.1 **AAM** do të bëjë ri-kalkulimin e **Përpjesës së Sistemit Matës të Furnizuesit** për të gjithë **Furnizuesit**, në rastet vijuese:

(a) Në baza vjetore (deri më 20 Dhjetor) pas ri-kalkulimit të **Sasisë Vjetore të Energjisë** në përputhje me paragrafin 1.4.5; dhe

(b) Sa herë që një **Sasi Vjetore e Energjisë Jo-Interval** të ndryshohet në përputhje me paragrafin 3.1.2.

3.2.2 **AAM** do të bëjë ri-kalkulimin e **Përpjesës së Sistemit Matës të Furnizuesit** për **Furnizuesit** përkatës në **Datën e Transferimit të Furnizuesit** për një transferim të konsumatorit që është bërë i pakushtëzuar në përputhje me paragrafin 6.1.7 të **Rregullave të Tregut** ku **Sistemi Matës** relevant është **Sistem Matës Jo-Interval**.

3.3 Kalkulimi i Përpjesës së Sistemit Matës të Furnizuesit


3.3.1 **Përpjesa e Sistemit Matës të Furnizuesit** ($PSMF_A$) për **Furnizuesin "A"** do të kullohet me formulën :

$$PSMF_A = \frac{\sum SVE_{Ab}}{STEJI}$$

ku:

SVE_{Ab} është **Sasia Vjetore e Energjisë** për **Sistemin Matës Jo-Interval "b"** të regjistruar në **Llogarinë Dalëse "A"**;

$STEJI$ është **Sasia Totale e Energjisë Jo-Interval**.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Caktimin e Energjisë së Matur	PR-MO-008
	<i>vers. 1.0</i>	<i>Faqe 8 deri 8</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

4 Përdorimi

4.1 Përdorimi i Përpjesës së Sistemit Matës të Furnizuesit

4.1.1 **Përpjesa e Sistemit Matës të Furnizuesit** nuk do të përdoret nga **AAM** dhe **OT** si e dhënë e **Furnizuesit** përveç në qoftë se kërkohet në mënyrë eksplicite me **Rregullat e Tregut** si parashtrohet në paragrafin 16.4.3.

4.2 Ofrimi i Informatave

4.2.1 **AAM** do ti vë në dispozicion të **Furnizuesit** kalkulimet dhe ri-kalkulimet e tij të:

- (a) **Energjisë Dalëse Ditore Jo-Interval** ($EDDJl_d$);
- (b) **Indeksit të Daljeve Vjetore të Energjisë** ($XIEDV_d$); dhe
- (c) **Sasisë Totale të Energjisë Jo-Interval**.

4.2.2 **AAM** do ti vë në dispozicion të **Furnizuesve** individual, kalkulimet e tij në lidhje me kalkulimin e **Sasisë Vjetore të Energjisë** dhe **Përpjesën e Sistemit Matës Jo-Interval** në lidhje me **Sistemet Matëse** të regjistruara në **Llogarinë Dalëse të Furnizuesit** por do të ruaj konfidencialitetin e të dhënave.